



**BASHKIA KORÇË**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT  
DHE MENAXHIMIT TË KONTRATAVE TË INFRASTRUKTURËS**

**RELACION**

**CHILDREN INNOVATION AND CREATIVE HUB  
REHABILITIM I QENDRËS INOVATIVE DHE KREATIVE PËR  
FËMIJË“THOMA TURTULLI”**

**KORÇË**



## **1. HYRJE**

TË DHËNAT KRYESORE:

1. Biblioteka e femijëve “Thoma Turtulli” Korçë.
2. Adresa : Lgj.12, Rruga “ Raqi Xhirinxhi” Nr.30, K.p.7001
3. Nën njësia KO/UB 463 Trashëgimmi dhe Monumete kulture dhe Natyrore
4. Kategoria : UB\_ Urban
5. Sipërfaqe e truallit 341.6 m<sup>2</sup>.
6. Sipërfaqe ekzistuese e katit përdhe 271.4 m<sup>2</sup>.
7. Sipërfaqe ekzistuese e katit -1 do të jëtë 271.4m<sup>2</sup>.

## **2. PËRSHKRIMI I ZONËS DHE KONTEKSTI**

### **PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I ZONËS**

Korça është qyteti më i madh që ndodhet në juglindje të vendit. Korça ndodhet në lartësinë 850 metra mbi nivelin e detit.

Ndërtesa është në një zonë banimi me dendësi të lartë të popullsisë.

8. Kodi i njësisë është KO/UB 463 . UB\_ Urban Trashëgimmi dhe Monumete kulture dhe Natyrore






**Fig.1 : Pjesë nga PPV i Bibliotekës së fëmijëve “Thoma Turtulli”– Korçë lidhja me qendrën e qyteti**

## **TË DHENA TË ZONËS KLIMATIKE**

Korça shtrihet në pjesën juglindore të Shqipërisë. Klima është e tipit kontinental lokal, me temperature mesatare vjetore prej 11.4 °C. Temperaturat mesatare mujore arrijnë afërsisht 21.2 °C në Korrik dhe Gusht, ku maksimumi arrin në gusht me 34.4 gradë. Temperatura mesatare më e ulët është në Janar rreth 1.5 °C me një minimum prej -17.5 °C. Pozicioni gjeografik, mbizotërimi i kodrave dhe maleve bën që territori i Korçës të futet në zonën ku dimri është i ftohtë dhe vera është e freskët.



**Harta e shkëputur nga VKM 207 dt. 2017 e cila tregon zonën muze të qytetit të Korçës**

## **HISTORIKU I SHKURTËR I BIBLIOTEKËS SË FËMIJËVE “THOMA TURTULLI”**



## **RELACION REHABILITIM I QËNDRËS INOVATIVE DHE KREATIVE PËR FËMIJË” THOMA TURTULLI”**

Biblioteka e fëmijëve “Thoma Turtulli” ka përfunduar ndërtimin e saj në korrik të viti 1930. Ky objekt ishte dhuruar nga filantropi Korçar Thoma Turtulli i cili i dhuroi Korçës bibliotekën, kinemanë, liceun, spitalin dhe jetimorën. Ai i dhuroi qytetit arsimdashës të Korçës, bibliotekën, duke parë etjen e madhe për dije të korçarëve. Në qytetin tonë e rreth tij, ekzistonin shumë libra nga bibliotekat e dikurshme të Voskopojës, Vithkuqit e vetë Korçës si dhe të sjella dhe nga shoqëria “Vatra” e SHBA-ës. Kështu që biblioteka e bukur e Korçës, e inauguruar më 1930-ën, numëronte rreth 30000 libra, asaj kohe.





Fig.2 : Pamje e fasadës së bibliotekës së fëmijëve "Thoma Turtulli" Korçë

### **GJENDJA EKZISTUESE E BIBLIOTEKËS**



Foto të hyrjes kryesore në objekt.



## **RELACION REHABILITIM I QËNDRËS INOVATIVE DHE KREATIVE PËR FËMIJË” THOMA TURTULLI”**

Objeti ndodhet në zonën e mbrojtur të qytetit Objekti është i përbërë prej 2 katesh dhe ka një sipërfaqe totale 542.8 m<sup>2</sup>. Konstrukti kryesron i objektit është me mure mbajtëse.Kati përdhe i objektit ekzistues është sot biblioteka e fëmijëve të qytetit të Korçës.Biblioteka përbëhet nga salla leximi, zyra, arkiva, etj. Ky ambient ka një lartësi rreth 3.5 m. Hyrja kryesore në këtë institucion bëhet nëpërmjet shkallëve të poziconuara në fasadën lindore në lulishten “Themistokli Gërmenji”.



Foto të hapsirave të brëndhsme të objektit

Në katin -1 të këtij objekti ndodhen magazinat, ambientet mbështetëse të Bibliotekës dhe tualetet. Lartësia e këtij kati shkon deri në 2.4 m.Ky objekt ka edhe një hyrje dytësore e cila nuk përdoret në rrugën “Raqi Qirinxhi”. Herë pas here janë bërë ndërhyrje mirëmbatje në objekt..Ndërhyrje e fundit janë bërë në vitin 2017 ku është bërë rikonstruksion i çatisë.





## RELACION REHABILITIM I QËNDRËS INOVATIVE DHE KREATIVE PËR FËMIJË” THOMA TURTULLI”

Në tërësinë e tij, objekti ka nevojë për ndërhyrje në strukturën dhe në sistemet teknike, një pjesë e të cilave nga këto të fundit ose nuk funksionojnë në rregull ose nuk ekzistojnë fare.



Ky objekt sot ngrohet me pajisje elektrike të cilat nuk janë eficiente. Në sistemin e ngrohjes se tij nuk është ndërhyr asnjeherë. Ky object nuk plotëson kushtet e komfortimit termik, si rrjedhojë del nevoja përmirësimit të disa parametrave të kësaj ndërtese.

Përvec sa më sipër gjendja e përgjithshme e objektit ka probleme të tjera si:

### *1- Lagështi në pjesën veriore dhe perëndimore të objektit*





Fig.3 : Pamje e fasadës në veri të objektit



Lagështia në brëndësi të objektit, kryesisht në katin -1 vjen nga themelet, ullukët e degraduar dhe zona e gjelbër në veri të saj. Fasada perëndimore ka një disnivel me fasadën lindore. Në fasadën lindore degradimi i suvasë nga lagështira vjen si pasojë e degradimit të ullukëve. Një ndër arsyt kryesore të lagështisë është degradimi i ullukëve vertical dhe horizontal në secilën fasadë.



**Foto kati -1.**

*a) Muret e jashtme dhe fasada*





## **RELACION REHABILITIM I QËNDRËS INOVATIVE DHE KREATIVE PËR FËMIJË” THOMA TURTULLI”**

Pamja e mureve të jashtme kryesisht e fadës kryesore në lindje ka degradime të shumta. Si në sipërfaqet e suvatuara po ashtu dhe në kornizat Hyrja kryesore është e degraduar e mirë dhe e mirëmbajtur. Ndërsa fasadat e tjera në very në lindje dhe ne jug të objektit janë në gjendje shumë të degraduar nga lagështia e madhe dhe kërkohet një ndërhyrje e menjëhershme në termoizolim të saj. Muret nuk janë të termoizoluar dhe kanë një koeficient të lartë të transmetimit të nxehtësisë dhe të të temperaturave të ulta gjatë stinës së dimrit. Po ashtu probleme ka edhe me mbulesën në hyrja qendrore e cila vjen nga çatia fallco e cila mbulon hyrjen kryesore.

Në parapeti i çatisë në dy cepat e fasadës kryesore ndodhen dy skultura luanësh të cilët nga kushtet atmosferike janë degraduar Elementet dekorativ të fasadës





*b) Çatia*

Ndërtesa mbulohet me çati e cila nuk ka termo-izolim. Çatia është i vetmi element i cili është rinovuar vitet e fundit. Pesha e saj sot mbahet nga muret mbajtëse të bibliotekës. Gjendja e saj është relativisht e mirë; Ullukët e saj janë totalisht të degraduar si ullukët vertical po ashtu ato horizontal. Po ashtu kornizat e fasadës ekzistuese në lartësi të ullukeve janë shumë të degraduara.

*c) Tualetet*

Tualetet janë në gjendje jo të mirë. Lagështia ka sjellë shkëputjen e veshjes me pllaka të tualeteve. Kërkohej rinovimim dhe zëvendësim i veshjes me pllaka. Zëvendësimi i pajisjeve ekzistuese hidro-sanitare. Nuk ka probleme teknike.

*e) Dyert dhe dritaret e jashtme*

Nga konstatimi i bërë në vend kemi vënë re se dyert dhe dritaret e jashtme janë të gjitha me dru me xham tek . Janë në gjendje të degraduar pasi përdorimi i tyre gjatë ketyre viteve ka sjellë një amortizim të pjesshëm të tyre. Dritaret janë kryesisht me dy kanate të përshtashme për qytetin e Korçës.



Për shkak të efekteve të ngrohjes së urës në lidhjen midis murit dhe kornizës së dritares ndodh myku si shkak i kondensimit të ujit në pjesën e poshtme të dritares. Pra, në përgjithësi dritaret e ndërtesës, për nga cilësia, certifikimi, metodat teknike të instalimit, raporti i efikasitetit të energjisë, mund të themi se këto dritare rezultojnë me një performancë të dobët nga ajo që kërkohej nga standardet për efikasitetin e energjisë.

*f) Dera e jashtme.*



## **RELACION REHABILITIM I QËNDRËS INOVATIVE DHE KREATIVE PËR FËMIJË” THOMA TURTULLI”**

Dera kryesore e ndërtesës është druri, me një lartësi prej 2,5 m. Në sipërfaqen e jashtme të saj janë të skalitur detaje e korniza si në foton e paraqitur më lart. Një pjesë e saj perbehët prej xhami e cila lejon kalimin e dritës. Kjo sipërfaqe xhami është e mbyllur me kanxhellë të jashtme.

Ne kemi konstatuar se dera e jashtme duhet të bëhet e re për arsye arkitektonike dhe funksionale.

*g) Dyert e brendëshme:*

Dyert e brendshme ekzistuese në katin përdhe janë dyert druri të përmasave të ndryshme. Në katin -1 dyert emtiefi të thjeshta Pjesa më e madhe e këtyre dyerve kanë probleme dhe duhen zëvendësuar.

### **SISTEMI ELEKTRIK DHE I NDRIÇIMIT**

Kërkon një përshtatje të sistemit të ri funksional të bibliotekës. Pasi rehabilitimi i brendshme dhe përshtatja e ambienteve me funksionet e reja si me zonat kreative apo ato te multi medias kërkon një kujdes të veçantë të sistemit ndriçimit pasi lartësia e objektit shkon deri në 3.5 m dhe funksioni i saj parësor biblioteke për fëmijët ku mund të qëndrojnë në studim edhe për kohë të gjata kërkon respektimin e normativave europiane te ndriçimit. Kërkohet që syri I lexuesit të mos lodhet para kohe gjatë një lëximi të gjatë. Për një ndriçim të mirë kërkohet 500 Lux dhe UGR < 16/19. Mund të instalohen ndriçues të varuar ose ku është e nevojshme edhe statikë me spote ose ndriçim tavoline. Krijimi i një ambienti të ndriçuar mirë ndihmon punën nxënësit ose fëmijët në përqendrimin sa më të mirë të kërkimit të tyre.

Kërkon pozicionimin e tavolina pune të reja me pozicione të reja kompiuterike. Ky sistem nuk është në gjendje të keqe. Intensiteti i ndriçimit nuk ka përmbushur normat dhe në disa hapësira janë përdorur llamba inkandeshente. Ka nevojë për të bërë instalime të reja shitesë dhe instalimin e sistemit të ri të ndriçimit efikas për të arritur intensitetin e ndriçimit sipas normave. Për të shmangur të gjitha rreziqet që vijnë nga sistemi elektrik në gjendje jo të mirë, është propozuar që shpërndarësit, siguresat, instalime elektrike, çelsin, priza, dhe ndriçimi të rinovohen.

### **SISTEMI HIDRO - SANITA**

Në këtë sistem nuk është ndërhyrë prej shumë vitesh vitet e fundit në këtë shkollë dhe ka një gjëndje të mirë. Në këto kushte do të bëhet vendosja e dy panele diellore që ndgrohja e ujit të bëhet me një sistem efficient. Në këto kushte nuk plotësohen kërkesat për ujë të ngrohtë sanitar tek tualetet që është shumë e nevojshme duke patur parasysh destinacionin e objektit.



## **RELACION REHABILITIM I QËNDRËS INOVATIVE DHE KREATIVE PËR FËMIJË” THOMA TURTULLI” SISTEMI I NGROHJES**

Sistemi ekzistues i ngrohjes është me korent por nuk ka efijencën e duhur pasi nxehtësia humbet nga muret dhe dritaret. Ky sistem nuk është i përshtatshëm për ambientet e një biblioteke për fëmijë. Sistemi i ngrohjes do të bëhet tërësisht i ri me ngrohje qendrore kondicioner multi split pasi objekti është në zonë monument culture dhe nuk është e lejuar vendosja e tyre në fasadë.

Pozicionimi i njësisë qendrore do të bëhet në truallin e lire në perëndim të objektit. Përshtatja e tij bëhet sipas normativave përkatëse. Kërkohej që çdo ambient të ketë ngrohje si në salla leximi, korridore, zyra apo ambiente të hapura. Ngrohja nuk është e nevojshme në arkiva, magazine apo tualete. Por duhet të ketë sistem ajrimi shumë të mirë dhe kontroll të lagështirës në të gjithë ambientet. Temperaturat e brendshme duhet të arrijnë nga 18 – 22 grade celcius dhe lagështia duhet të ketë vlerat rreth 55%.

Ndërkohë që këto mangësi do të rregullohen me masa të efijencës së energjisë që do të ndërmerren (të tilla si muret, dritaret, ndriçimi, si pjesë e sistemit elektrik dhe të sistemit të ujit të ngrohtë sanitar), ka edhe prej disa punime që kërkojnë ndërhyrje strukturore në ndërtesë. Ndërhyrje të tilla mund të jenë si: sivatime të jashtme dhe të brendshme; rinovime të dyshemeve (shtresave) përfshirë izolime hidrike, pllaka, etj; zëvendësimi i të gjitha dyerve të brendshme, etj, të cilat kanë të gjitha kostot e tyre të investimeve.

### **SISTEMI KONSTRUKTIV**

Objekti është ndërtuar në vitin 1930, nga ajo kohe sistemi konstruktiv nuk është prekur. Ky sistemim ka nevojë për meremetime pasi tërmeti i vitit 2019 shkaktoi plasaritje të lëhta të cilat me kalimin e viteve janë hapur akoma më shumë.



Çarjet janë kryesisht vertikale. Një pjesë e madhe e tyre fillojnë në dyert e dritaret e murrin mbajtës perimetral të objektit. Do të bëhen përforcime të themeleve në zona ku është e nevojshme hapje



**RELACION REHABILITIM I QËNDRËS INOVATIVE DHE KREATIVE PËR FËMIJË” THOMA TURTULLI”**  
të mureve mbajtës për hyrje dalje të ambienteve sipas planimetrisë përkatëse të secilit kat të ndryshuar. Vetrata ekzistuese do të spostohet pasi ka ndryshime në planimetri.

Ashensori

Kërkohet zgjidhja e aksesit për persona me aftësi të kufizuara. Hyrja kryesore e propozuar është në jug të shkallëve në hyrjen kryesore. Vendosija e një ashensori të hapur i cili con në katin përdhe.

Punoi

DREJTOR

Ark. Edona Venxha

Ndriçim Hoxha